



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3237/ 19 prot.

Datë 08.04.2024

V E N D I M

Nr. 354/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Tërnova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 294/2024, datë 25.03.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-88777-11-22-2023, me objekt “Furnizim dhe shërbime me ushqim për menca” me fond limit 8,373,300.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “4S” SHPK, nr. NIPT L64425401K Lagjja “Xhevder Nepravishta”, Rruga “Qerim Arapi”, Pasuria nr. 24/104-N4.
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë. Rruga “Dritan Hoxha”, Njësia Administrative nr. 11, Laprakë, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.03.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 294/2024, ku vendosi:

[...]1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “4S” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-88777-11-22-2023, me objekt “Furnizim dhe shërbime me ushqim për menca”, me fond limit 8,373,300.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.

2. Të konstatojë absolutisht të pavlefshëm vendimin e Komisionit Vlerësimit të Ofertave të datës 10.12.2023 dhe të gjithë hapat proceduralë të ndërmarrë prej tij pas rivlersimit të datës 10.12.2023, si vendime absolutisht të pavlefshme të marra në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe të rikthejë procedurën në gjendjen fillestare vetëm për këtë operator ekonomik ankimues, në mënyrë që të kryejë vlerësimin e tij, në përputhje me parashikimet e nenit 93, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4S” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 39/3 prot., datë 03.04.2024, protokolluar me tonën nr. 3237/16 prot., datë 08.04.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 294/2024, datë 25.03.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-88777-11-22-2023, me objekt “Furnizim dhe shërbime me ushqim për menca”, me fond limit 8,373,300.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 39/3 prot., datë 03.04.2024, protokolluar me tonën nr. 3237/16 prot., datë 08.04.2024 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 294/2024, datë 25.03.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-88777-11-22-2023, me objekt “Furnizim dhe shërbime me ushqim për menca”, me fond limit 8,373,300.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë..

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.294/2024, datë 25.03.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga ky verifikim rezultoi se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit duke kthyer procedurën në fazën e vlerësimit duke respektuar hapat procedural lidhur me operatorin ekonomik “4 S” SHPK për ofertën anomalisht të ulët, në zbatim të vendimit Nr.294/2024, datë 25.03.2024 të këtij Komisioni.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit ““E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-88777-11-22-2023, me objekt “Furnizim dhe shërbime me ushqim për menca”, me fond limit 8,373,300.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.12.2023, nga autoriteti kontraktor Qendra Komunitare për Personat me Aftësi të Kufizuar Tiranë..
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

